

MARREVESHJE

PER : BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE SHOQERIVE

“Premium Media” shpk dhe “RTV Adria-Med” shpk

Tirane me, 05.10.2022

Shoqeria “Premium Media” shpk eshte regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 14.12.2017 me seli Rruga Dervish Shaba, Rreth Rrotullimi i qendres tregtare, TEO, Blloku B-1, Mjull Bathore, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria “Premium Media”shpk me NIPT-in L72414030K, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 100.100 leke me kontribut 100% i ortakut te vetem Enver Mehmeti. Administrator i shoqerise eshte Enver Mehmeti..

Shoqeria “RTV Adria-Med” shpk eshte regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 12.10.2010 me seli Lagja Mjull Bathore, Rruga Dervish Shaba, rreth rrotullimi qendres tregtare TEG, blloku B-1, Tirane.

Shoqeria “RTV Adria-Med” shpk me NIPT-in L02212502M, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 650.000 leke me kontribut 100% i ortakut te vetem Enver Mehmeti. Administrator i shoqerise eshte Enver Mehmeti..

Pas bisedimesh paraprake organet vendimarrese te dy shoqerive kane rene dakort per bashkimin e shoqerive, ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” te nenit 215 pika 1.

Ne zbatim te nenit 216 pika 1 te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” hartohet ky projek per bashkimi e shoqerive me keto kushte :

1.Bashkimi do te kryhet ne formen e perthithjes ku shoqeria tregtare “**Premium Media**” shpk do te jete shoqeria perthithese dhe shoqeria tregtare “**RTV Adria-Med**” shpk do te jete shoqeria e perthithur.

2.Raporti kembimit te Kuotave do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” neni 68 pika 2 ku çdo ortak do te kete nje kuote, ndersa pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do te jete mbi bazen e vleres ne leke qe ze shumën e kapitalit themeltar te sejciles shoqeri qe merr pjese ne procesin e perthithjes ndaj kapitalit themeltar te shoqerise



se re pas perthithjes e rrjedhimisht dhe sejcili ortak ne raport me pjesemarrjen ne kapitalit themeltar te shoqerise qe merr pjese ne procesin e perthithjes e me pas me raportin e sejcilit ortak ne kapitalin themeltar te shoqerise se re pas perthithjes.

3.Kushtet e ndarjes se kuotave te shoqerise pas bashkimit me perthithje do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" neni 68 pika 2 ku çdo ortak do te kete nje kuote, ndersa pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do jete mbi bazen e rraportit qe ze sejcili kapital themeltar i shoqerive te veçanta ndaj totalit te kapitalit themeltar ne shoqerine e re.

4.Data, duke u nisur nga e cila zotëruesit e kuotave (ortaket e shoqerise se re pas perthithjes) kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit do te jete 01.01.2022.

5.Data, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë "**RTV Adria-Med**" shpk që përthithet do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë përthithëse "**Premium Media**" shpk do te jete 01.01.2022.

6.Të drejtat që shoqëria përthithëse "**Premium Media**" shpk u njeh zotëruesve të kuotave (ortakeve), jane ato qe percaktohen ne statutin e shoqerise perthithese "**Premium Media**" shpk. dhe ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

7.Perparesite apo kufizimet e Administratorit te shoqerise se re pas perthithjes do te jene ato qe i njeh statuti i shoqerise perthithese "**Premium Media**" shpk. dhe ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

8.Pasojat e bashkimit nuk do te kene asnje influence ndaj te punesuarve te te dyja shoqerive qe marrin pjese ne procesin e perthithjes.

9.Pasojat e bashkimit nuk do te kene asnje influence ndaj te treteve te sejciles shoqeri para perthithjes.

10.Ortake te shoqerise se re do te jene: **Enver Mehmeti**

11.Emri i shoqerise se krijuar nga bashkimi do te jete "**Premium Media**" shpk

12.Selia e shoqerise se re do jete ajo e shoqerise "**Premium Media**" shpk: Rruga Dervish Shaba, Rreth Rrotullimi i qendres tregtare, TEO, Blloku B-1, Mjull Bathore, Tirane, Shqiperi.

13.Statuti i shoqerise se re pas perthithjes do te jete ai i shoqerise "**Premium Media**" shpk para perthithjes

14.Objekti veprimtarise i shoqerise se re pas perthithjes do te jete ai i shoqerise "**Premium Media**" shpk para perthithjes

15.Administratore e shoqerise se krijuar nga bashkimi do jete **Enver Mehmeti** me nje mandat 5 vjeçar.

16.Baza e nisjes per bashkimin do te jene treguesit e bilancit te dates 31.12.2021, ndersa aktiviteti i vitit 2022 do te jete i perbashket me sisteminimet e nevojeshme sipas Standarteve Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara ne zbatim te ligjit 25/2018 dt.



10.05.2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Te gjitha korigjimet e mundeshme do te behen ne bilancin e celjes te shoqerise "**Premium Media**" shpk para perthithjes.

17. Kapitali aksioner dhe Perqindjet (te trajtuara ne pikën 2 dhe 3 si me siper) e sejenit ortak ne kapitalin e ri themeltar te krijuar nga bashkimi do te percaktohen pas paraqitjes se aktit te ekspertimit nga shoqeria Audituese "Gosnishti Auditors And Partners" shpk me Nipti-in L32423013P e regjistruar ne regjistrin publik te Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar (IEKA) me Nr. 398 date 31.03.2004.

18. Fitimi nga kapital i tatusem ne zbatim te ligjit 8438 date 28.12.1998 „Per Tatimin mbi te Ardhrurat“ i ndryshuar (shtuar me ligjin 163/2020 date 23.12.2020) neni 32/1 pika 2, dhe 3, te po ketij neni theksojme se si per shoqerine blerese ashtu dhe per shoqerine e blere eshte i te njejte per ortakune **Enver Mehmeti** dhe, bashkimi me perthithje behet mbi bazen e bashkimit te kapitaleve te te dyja shoqerive, pra nuk ka pagese te cilesuar ne te holla te marra lidhur me shkembimin e kuotave, qe te njihet si fitim kapital i tatusem.

19. Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise "**RTV Adria-Med**" shpk do t'i kalojne shoqerise "**Premium Media**" shpk.

20. Shoqeria perthithese "**Premium Media**" shpk dhe shoqeria e perthithur "**RTV Adria-Med**" shpk me miratimin e Ortakeve me të drejtë vote, të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim, ne zbatim te pikes 7 te nenit 216 te ligjit 9901 date 14.4.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", perjashtojne detyrimin për pasqyrat kontabël të përmendura në pikën 5, si dhe të njoftimit sipas pikës 6, po te nenit 216 te ligjit 9901 date 14.4.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare"

Per Shoqerine "**Premium Media**" shpk

Perfaqesuesi Ligjor

Enver Mehmeti



Per Shoqerine "**RTV Adria-Med**" shpk

Perfaqesuesi Ligjor

Enver Mehmeti

